



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

SQARIM MBI DOKUMENTAT E TENDERIT Nr. 2

Referuar kërkesës për informacion të dërguar nga operatore të interesuar, si edhe bazuar në pikën 6.1 dhe pikën 17.1, të VKM-së nr. 1252, datë 10.9.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, Njësia e Hartimit të Dokumentave të Tenderit, sqaron të interesuarit si më poshtë:

Në përputhje me parashikimet e kreut XIII të ftesës për ofertë, kreut II/3 të dokumentit të tenderit si dhe grafikut të zhvillimit të tij, po paraqesim këtë kërkesë për sqarime shitesë mbi disa prej kushteve në përmbajtje të dokumentit si mëposhtë vijon:

Mbi kushtet e mbulimit në shkallë popullsie:

Pyetje 1:

Referuar dokumentit të tenderit, nga operatori fitues i brezit të frekuencave objekt tenderimi, kërkohet mbulimi me shërbim në shkallë popullsie:

% Popullsie	Afati (viti)
55% e popullsisë	2027
85% e popullsisë	2030

Sqarim: Me detyrimin e mbulimit me shërbim në shkallë popullsie si më sipër, kuptojmë që ky detyrim do të arrihet nëpërmjet përdorimit të të gjitha bandave të frekuencave ekzistuese që janë në përdorim nga operatori dhe jo që ky kusht të jetë i kufizuar vetëm në bandat e frekuencave objekt të këtij tenderimi, pra 3400MHz – 3800MHz.

Përgjigje 1:

Lidhur me këtë pyetje, sqarojmë se objekti i këtij tenderi është “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz”. Në përputhje me objektin e tenderit, sqarojmë se mbulimi me shërbim në shkallë popullsie, pra përqindjet e mbulimit të popullsisë dhe afatet respektive, janë për rrjetin që do të ndërtohet me frekuenca të brezit 3400-3800 MHz. Çdo operator, i ri apo ekzistues, që do të pajiset me autorizim individual për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, do të zbatojë mbulimin me shërbim në shkallë popullsie, siç është

përcaktuar në seksionin XI, pika A-1) “Mbulimi me shërbim në shkallë popullore” dhe Shtojcën 20, të dokumentit të tenderit.

Operatori që do të pajiset me autorizim individual për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, mund të përdorë kombinim të brezave të ndryshëm të frekuencave, siç ndodh edhe sot, por operatori është i detyruar të zbatojë kushtet e mbulimit me rrjet dhe shërbime, për secilin brez frekuencash, siç janë përcaktuar në autorizimet individuale respektive. Pra, edhe për brezin 3400-3800 MHz, operatori që do të pajiset me autorizim individual, do të zbatojë përqindjet dhe afatet e mbulimit, me këto frekuenca, siç përcaktohen në dokumentin e tenderit, të cilat do të jenë edhe në autorizimet individuale që do të lëshohet për fituesit.

Mbi kushtet e mbulimit në territor:

Pyetje 2:

Referuar dokumentit të tenderit, nga operatori fitues i brezit të frekuencave objekt tenderimi, kërkohet mbulim me shërbimin 5G në brezin e autorizuar (pjesë e spektrit 3.4 GHz - 3.8 GHz), në të gjitha qytetet e Shqipërisë, deri në fund të vitit 2028.

Sqarim: Me detyrimin për mbulim për të gjitha qytetet në 3.5GHz, kuptojmë prezencën e sinjalit 5G në 3.5GHz me të paktën 1 (një) stacion në secilin qytet që mbulon institucionet publike kryesore dhe qendrën e qytetit.

Përgjigje 2:

Lidhur me këtë pyetje, sqarojmë se në seksionin XI, pika A - 3) e dokumenti të tenderit, përcaktohet si kusht mbulimi me shërbime 5G në brezin e autorizuar (pjesë e spektrit 3.4 GHz - 3.8 GHz), në të gjitha qytetet e Shqipërisë, deri në fund të vitit 2028. Me qytet kuptohet hapësira territoriale, siç është përcaktuar në Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe jo vetëm qendra e qytetit. Ndërkohë duke ditur karakteristikat teknike të mbulimit me sinjal dhe shërbime, të antenave që operojnë në brezin 3400-3800 MHz (5G), teknikisht do të ishte e pamundur mbulimi i territorit të qytetit, me vetëm 1 stacion. Pra, operatori që do të shpallet fitues dhe do të pajiset me autorizim individual, deri në fund të vitit 2028, duhet të mbulojë me shërbime të lëvizshme, nëpërmjet rrjetit të ndërtuar me frekuenca të brezit 3400-3800 MHz, hapësirën territoriale të të gjithë qyteteve dhe numri i stacioneve duhet ti përgjigjet këtij kushti.

Pyetje 3:

Referuar dokumentit të tenderit, nga operatori fitues kërkohet që, sipas rastit dhe bazuar në raportet e matjeve, të vendosë në parametrat e kërkuara të cilësisë së mbulimit me shërbim sipas përcaktimeve në aktin rregullator përkatës të AKEP, për zona të rëndësishme të veçantë ku përfshihen: zonat turistike, parqet kombëtare, rrugët, autostradat, tunelet dhe zonat me rëndësi zhvillimore.

Sqarim: A. Me kërkesën për raportin e matjeve për mbulimin e zonave të specifikuar më sipër kuptojmë që raportimit aktual të KPI të cilësisë së shërbimit do i shtohen edhe KPI për 5G si dhe që kjo pikë nuk ka për qëllim të përcaktojë detyrime të tjera shtesë mbulimi të ndryshme nga kushtet e mbulimit të përcaktuara në Shtojcën 6 dhe në pikën 2.1 të Aneksit 1 të Autorizimit publikuar më dokumentin e tenderit.

B. Nga ana tjetër, për të suportuar transmetimin optimal të 5G në 3.5GHz, kërkojmë që AKEP të rishikojë cmimet shumë të shtrenjta të bandës E të cilat mund të përdoren për të mbështetur kapacitetet 10Gbps në zona ku rrjeti me fibër nuk është prezent dhe është e pamundur të arrihet.

Përgjigje 3:

Në seksionin XI, pika B - 3), Shtojcën 6 dhe në pikën 2.1 të Aneksit 1, të dokumentit të tenderit, përcaktohet se:

- I- Sipërmarrësi është i detyruar që, sipas rastit dhe bazuar në raportet e matjeve, të vendosë në parametrat e kërkuara të cilësisë së mbulimit me shërbim sipas përcaktimeve në aktin rregullator përkatës të AKEP, për zona të rëndësishme të veçantë ku përfshihen:
- zonat turistike,
 - parqet kombëtare,
 - rrugët, autostradat e tunelet,
 - zona të përfshira në projekte zhvillimore të ndryshme.

Në lidhje me kërkesën për rishikimin e çmimit të bandës E, sqarojmë se:

Në vendet e CEPT (ITU Rajoni 1), ku bën pjesë edhe Shqipëria, banda E përbëhet nga disa pjesë të spektrit të frekuencave nga 60 deri 90 GHz. Rishikime çmimesh për bandën E, nuk janë objekt i kësaj procedure tenderimi dhe nuk mund të shqyrtohet.

Gjithashtu, sqarojmë se pagesat që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Pyetje 4: Mbi procedurën e tenderimit me 5 raunde

Referuar seksioni I të Ftesës për Oferte, dhe seksionit 2 të Dokumentit të Tenderit, rezulton që:

- Vlerësimi do të jetë i përshkallëzuar, me 5 raunde vlerësimi.
- Të gjithë ofertuesit mund të paraqesin oferta për pjesëmarrjen në tender për çdo raund vlerësimi, ku mund të ofertohet për sasi të spektrit ndarë në 2 blloqe nga 80 MHz, për raundin e parë dhe të dytë dhe 3 blloqe nga 40 MHz, për raundin e tretë, të katërt dhe të pestë.
- Ofertuesi i cili është shpallur fitues në raundin e parë, skualifikohet për raundin e dytë.
- Një ofertues NUK mund të fitojë më shumë se 3 (tre) të drejta përdorimi ose 160 MHz sasi spektri.

Sqarim: Nisur nga përshkrimi në dokumentin e tenderit të procedurës së vlerësimit, kuptojmë që nëse një ofertues ka dorëzuar oferta për pjesëmarrje në të gjitha raundet por, përpara hapjes së ofertave të raundit të radhës (psh: përpara hapjes së ofertave për raundin e katërt) vendos të tërhiqet nga oferta për atë raund, ofertuesi do të ketë kohën dhe mundësinë të paraqesë Kërkesë për Tërheqjen nga Oferta për atë raund.

Përgjigje 4:

Duke qenë se vlerësimi i ofertave do të jetë i përshkallëzuar, me 5 raunde vlerësimi, AKEP, në përfundim të vlerësimit për secilin raund, do të njoftojë ofertuesit për hapjen e raundit të radhës. Të interesuarit që duan të tërheqin ofertën e tyre nga tenderi, mund të paraqesin një kërkesë për tërheqjen, për secilin raund deri në momentin që do të hapen ofertat për raundin e radhës. Tërheqja duhet t'i komunikohet AKEP-it me shkrim para hapjes së raundit të radhës. Kërkesa e Ofertuesit për tërheqjen e ofertës duhet të depozitohet, e futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Tërheqje Oferte". Oferta e tërhequr do t'i kthehet ofertuesit e pahapur.